



## Seanca trajnimi mbi zhvillimin e aftësive në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

Në shtator 2008, Qendrat e Shërbimit për Migrantët në Shkup dhe Bitola kanë zhvilluar katër seanca për të ndihmuar klientët për hartimin e CV dhe zhvillimin e aftësive kualifikuese për përfshirjen e tyre aktive në tregun e punës në vend.



Me shumë se 60 klientë kanë përfituar nga seancat orientuese si nëpërmjet këshillimit individual ashtu dhe përmes punës në grup. Seancat e orientimit janë organizuar në bazë të nevojave të klientëve dhe janë zhvilluar në bashkëpunim me stafin e Agjencisë së Punësimit.

Gjatë këtyre seancave ofrohen sugjerime mbi mënyrat e kërkimit të punës duke pasur si objektivi integrimin më të mirë në tregun vendas të punës. Janë organizuar gjithashtu ushtrime praktike në lidhje me hartimin e CV-ve, intervista të improvizuara si dhe janë identifikuar mundësitë e punësimit nëpërmjet kërkimit në internet.

## Statistika të përzgjedhura mbi klientët e Qendrave të Shërbimit për Migrantët / Sporteleve të Migracionit (qershor-gusht 2008)

IOM ka grumbulluar statistika mbi përfituesit e shërbimit të ofruara nga Qendrat e Shërbimit për Migrantët/Sportelet e Migracionit që nga fillimi i projektit. Numri total i klientëve të regjistruar pranë këtyre qendrave gjatë tremestrit të parë të veprimtarisë së tyre (qershor-gusht 2008) është 1003, nga një numër total vizitash prej 1012. Pjesa më e madhe e klientëve janë vendas, dhe një përqindje e vogël janë imigrantë në këto vende (6.7%). Përmbledhja e mëposhtme i referohet vetëm rasteve të vendasve (për të parë raportin e plotë vizitoni faqen e internetit të projektit në adresën [www.migrantservicecentres.org](http://www.migrantservicecentres.org)).

Numri më i madh i vizitoreve është regjistruar në Kosovë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipëri. 75% e klientëve janë meshkuj kryesisht në moshën 30-35 vjeç. Pjesa më e madhe e klientëve vijnë nga zonat urbane.






Të papunët përbënin një pjesë të madhe të klientëve të Qendrave të Shërbimit për Migrantët/Sporteleva të Migracionit (61%). Është paraqitur gjithashtu një shifër e lartë e sektorëve të punësimit.

Më shumë se gjysma e vizitorëve kanë emigruar më parë. Pjesa më e madhe e klientëve që kishin emigruar më parë kishin aplikuar për azil ose për punë. Gjermania, Greqia, dhe Zvicra ishin ndër vendet më të kërkuara.

Pjesa më e madhe e klientëve të interesuar për migracion me motive punësimi deklarojnë Kanadanë, Italinë, Gjermaninë, SHBA dhe Australinë si vende të preferuara të destinacionit.



Asistenca e ofruar nga punonjësit e Qendrave të Shërbimit për Migrantët/Sporteleva të Migracionit ishte kryesisht dhënie informacioni (84%) e ndjekur nga këshillimi dhe referimi që zënë respektivisht 10% dhe 6% të shërbimit.

**Statistika të bazuara në informacionin e marrë nga Qendrat e Shërbimit për Migrantët/Sportelet e Migracionit:**



Numri total i imigrantëve të regjistruar pranë Qendrave të Shërbimit për Migrantët/Sportelevë të Migracionit ishte 68. Numri më i madh i vizitorëve imigrantë është regjistruar në Shqipëri, Mal të Zi dhe Kroaci. Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë nuk kanë pasur kërkesa nga imigrantë.

Shumica e imigrantëve janë të punësuar dhe janë pajisur me leje pune.



Mbledhjet e Komitetit Drejtues:

- Shkurt 2008 – Beograd
- Shtator 2008 – Sarajevë
- Shkurt 2009 – Tiranë
- Korrik 2009 - Zagreb

**Paketat Informuese** për Shqipërinë, Australinë, Austrinë, Belgjikën, Bosnje & Hercegovinën, Bullgarinë, Kanadanë, Republikën Çeke, Kroacinë, Qipron, Danimarkën, Estoninë, Finlandën, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Francën, Gjermaninë, Greqinë, Hungarinë, Hollandën, Irlandën, Italinë, Kosovën, Letoninë, Lituaninë, Luksemburgun, Maltën, Malin e Zi, Mbretërinë e Bashkuar, Norvegjinë, Poloninë, Portugalinë, Rumaninë, Serbinë, Sllovakinë, Slloveninë, Spanjën, Suedinë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zelandën e Re dhe Zvicrën, mund t'i gjeni në faqen e internetit:  
[www.migrantservicecentres.org/index.php?](http://www.migrantservicecentres.org/index.php?)

Për më shumë informacion mbi partnerët, aktivitetet, lajmet e fundit dhe të dhënat statistikore vizitoni:

[www.migrantservicecentres.org](http://www.migrantservicecentres.org)



Schweizerische Eidgenossenschaft  
 Confédération suisse  
 Confederazione Svizzera  
 Confederaziun svizra

